

MASAT PARAMBROJTJESE:

- Mbajeni në vende të sigurta dhe larg fëmijëve, ushqimeve të njerëzve dhe kafshëve, ujit të pijshëm.
- Gjatë punës mos hani dhe mos pini lëngje e duhan.
- Gjatë punës vishni rrobat e punës, pajisjet mbrojtëse për sytë dhe fytyrën (doreza, syzet, mbrojtësen e fytyrës, etj).
- Mbas punës dhe përpara ngrënies lani duart dhe pjesët e ekspozuara të lëkurës me ujë të bollshëm dhe sapun.
- Mbas mbarimit të punës lani pajisjet mbrojtëse, mjetet e sperkatjes dhe asgjësoni ambalazhet sipas ligjeve në fuqi.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

- Në rast kontakti më lekurën lajeni me ujë të bollshëm dhe me sapun.
- Në rast kontakti me sytë lani menjëherë me ujë të bollshëm dhe konsultohuni me mjekun.
- Në rast qëllitje kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Në rast dëmtimi, largojeni pacientin nga zona e rrezikut. Nëse i dëmtuari ka humbur ndjenjat, shtrijeni dhe transportojeni në pozicion anësor. Hiqini menjëherë rrobat e ndotura. I tregoni mjekut etiketën e preparatit.
- Nuk ka antidot specifik. Mjekimi sipas simptomave.



Data e prodhimit: Printuar në ambalazh
Afati i ruajtjes: 3 vjet

1 Litër

KOHINOR 200 SL

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



Lënda vepruese: 200 gr/lit Imidacloprid

Formulimi: Lëng i tretshëm (SL)

Nr. i regjistrimit: Nr. 568; datë 17/09/2014

Insekticid sistemi me bazë
Imidacloprid, lëndë vepruese e
përfshirë në Neonikotinidet.
Veçanërisht i përshtatshëm për
kontrollin e afideve dhe aleuroideve,
efikas kundër fitofageve me aparat
gojor shpues thithës dhe brerës.
Produkt ideal për programet e kontrollit
të integruar të parazitëve (IPM).



Distributor:
MELDI Sh.p.k.
Tirane - Shqipëri



Aplikant: ADAMA Agriculture BV
Prodhuesi: ADAMA Makhteshim Ltd



Përdorimi:

Me spërkatje gjethore si dhe me ujitje nëpërmjet rrënjëve. Në rast të përdorimit me ujitje doza është 1-2 ml/m².

Në pemët frutore dhe agrume: për kontrollin e afideve, tenjave minuese, morrin e përgjakshëm, grerëzat e frutave, pleshtin e dardhës dhe lepidopterët.

Në ullinj: për kontrollin e pambukoreve, mizës se ullirit (Dacus olea) dhe lepidopterëve.

Në vreshta: për kontrollin e tenjave te rrushit, minueseve.

Në perime: për kontrollin e krahëbardhave, minueseve të gjetheve, tripsit, afideve, dipterëve si: miza e qepës, lakrës, karrotës, etj.

Në patate: për kontrollin e buburrecit, tenjës dhe afideve.

Në duhan: për kontrollin e afideve dhe tripsit.

Në bimët zbukurose: për kontrollin e afideve, tripsit dhe minueset e gjetheve.

Doza e përdorimit është 50-75 ml/100 lit ujë.

Vërejtje për përdorimin:

Nuk duhet të kryhet më shumë se dy trajtime në sezon.

Mund të përzihet me shumicën e fungicideve dhe insekticideve të tjera, me përjashtim të atyre me reaksion alkalin.

Ndikimi në ekosistem:

Dëmton bletën dhe faunën e dobishme, prandaj të mos përdoret në kohën e lulëzimit. Nuk ka veprim largues ndaj bletës dhe insekteve të tjera pjalmuese. Shumë helmues për organizmat ujore, mund të shkaktojë efekte të këqia afatgjata në mjediset ujore. Mos ndotni ujrën dhe burimet ujore që rrjedhin në lumenj e rezervuarë uji. Për të mbrojtur organizmat ujore, të respektohet një zonë mbrojtëse prej 10 m.

Karenca: Në ullinj dhe agrume 14 ditë; Perime 7 ditë; Rrush dhe pemë frutore 28 ditë; Patate 14 ditë.

Magazinimi: Ruajeni në ambalazhin origjinal, në vende të thata, të ajrosura e të pa ekspozuara nga drita direkte e diellit nën temperaturën 35°C